



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ..... 67 ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 17 / 04 / 2025

**VENDIM**  
nr.13, datë 17 /04 /2025

**PËR**

**RAPORTIN VJETOR 2024 PËR GJENDJEN, SHFRYTËZIMIN, MONITORIMIN DHE SIGURINË E DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Kreu II, Neni 4 si dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave e Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim raportin vjetor për vitin 2024 nga KESH, që është shfrytëzuesi dhe administratori i 6 digave të mëdha, në lidhje me gjëndjen, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e këtyre digave. Bazuar në informacionin e dhënë në këtë raport si dhe në inspektimet e kryera në terren nga ekipet e KKDM dhe ITD rezultoi se pranë KESH është ekipi i monitorimit dhe sigurisë së digave në qendër dhe në cdo HEC si dhe janë të instaluarat sistemet e monitorimit të të gjithë digave dhe sistemi i Alarmit në rastet e emergjencave civile. Njëkohësisht, vihet re se, megjithë kërkesat zyrtare të KKDM, nuk është paraqitur një analizë dhe studim në lidhje me nivelet dhe prurjet e ujit në kaskadë gjatë 5 viteve të fundit duke i krahasuar me të dhënat e projektit dhe me nivelet dhe prurjet që mund të ndodhin një herë në 100 vjet, 1000 vjet dhe PMF. Kjo kërkesë është e nevojshme në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe kërkesave të eksperteve të huaj dhe vendas të shprehura në studimet e viteve të fundit për rritjen e kapaciteteve shkarkuese në digat e HEC Koman dhe HEC Fierzë, rezultateve të matjeve batimetrike në të 3 rezervuarët e kaskadës si dhe të përditësimit të rregullores së shfrytëzimit dhe menaxhimit të prurjeve dhe shkarkimeve në kaskadën e lumit Drin. Njëkohësisht, gjatë inspektimeve në terren janë vërejtur se në digën e HEC Koman është dëmtuar sistemi i grumbullimit dhe monitorimit të filtrimeve tek dhëmbi në anën e poshtme të digës si dhe sistemi i shkarkimit fundor në digën e Qyrsaqit. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm KKDM.

**VENDOSI:**

- 1- Të miratoj Raportin Vjetor për vitin 2024 të paraqitur nga KESH në lidhje me gjëndjen, shfrytëzimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e digave të kaskadës së lumit Drin.
- 2- Ti kërkoj KESH përgatitjen dhe dorëzimin pranë KKDM të një Raporti teknik në lidhje me analizën dhe studimin e kërkuar për nivelet dhe prurjet e ujit në kaskadë gjatë 5 viteve të fundit duke i krahasuar dhe analizuar me të dhënat e projektit origjinal, të dhënat e matjeve batimetrike të rezervuarëve si dhe me nivelet dhe prurjet që parashikohet të ndodhin një herë në 100 vjet, një herë në 1000 vjet dhe në rastin e PMF. Kjo analizë duhet të marrë në konsideratë edhe rezultatet e studimeve të mëparshme nga ekspertet e huaj dhe vendas. Në raport duhet të jepet edhe informacioni në lidhje me masat e parashikuara nga KESH në lidhje me rritjen e kapaciteteve shkarkuese të digave në HEC Koman dhe HEC Fierzë sipas kërkesave të eksperteve. Ky Raport duhet të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Qershor 2025
- 3- Ti kërkoj KESH marrjen e masave të duhura për rehabilitimin e sistemit të grumbullimit dhe monitorimit të filtrimeve tek dhëmbi në anën e poshtme të digës së HEC Koman si dhe masat për rehabilitimin e sistemit të shkarkimit fundor në digën e Qyrsaqit në HEC Vau i Dejës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 4- Të informoj Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me problematikat e konstatuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Vendimi dhe kërkesat e KKDM për zgjidhjet e tyre.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen e detyrave të dhëna në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

